



[www.d4d-ks.org](http://www.d4d-ks.org)

Democracy for Development

Demokraci për zhvillim

Demokratija za razvoj

# RAPORTIMI I LAJMEVE NGA PORTALET ONLINE

*Rrjetet sociale dhe ndikimi tek publiku*



Të drejtat e autorit ©2022. **Demokraci për Zhvillim (D4D)**.

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Përveç citimeve të pjesëve të shkurtra me qëllim të kritikës dhe rishikimit, asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të rikthimit të të dhënave, ose të transmetohet në çfarëdo forme apo mjeti, elektronik, mekanik, fotokopjues, regjistruar ose tjetër, pa lejen paraprake të D4D.

Punim i përgatitur nga:

Instituti Demokrasi për Zhvillim

–

Ky raport është publikuar nga Instituti Demokrasi për Zhvillim (D4D) në kuadër të projektit “Luftimi i keqinformimit dhe rikthimi i besimit të qytetarëve ndaj mediave”, që mbështetet nga NDI dhe USAID. Përmbajtja e dokumentit është përgjegjësi e Institutit Demokrasi për Zhvillim dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se pasqyron qëndrimin e NDI dhe USAID.

## Tabela e përmbajtjes

1	<b>HYRJA</b> .....	4
2	<b>METODOLOGJIA</b> .....	6
3	<b>TË GJETURAT KRYESORE</b> .....	10
4	<b>KONKLuzionet</b> .....	43
5	<b>REKOMANDIMET</b> .....	45
6	<b>SHTOJCAT</b> .....	48

# 1 | Hyrja

Shpërndarja e informacionit në ditët e sotme bëhet në kohë rekorde për shkak të zhvillimit të teknologjisë dhe mjeteve teknologjike siç janë telefonat e mençur, platforma të ndryshme si dhe rrjetet sociale, që e mundësojnë qasjen në kohë reale në ngjarje ditore. Në vitin 2022, sipas Datare portal 97% e popullatës kanë qasje në internet.<sup>1</sup> Për më tepër, sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) në vitin 2021 shpeshësia e përdorimit të internetit disa herë gjatë ditës ishte 80%. Çrregullimet e informacionit janë një trend global i cili ndodh edhe në vendet më demokratike, një trend i tillë natyrisht se ka qenë i pashmangshëm edhe në Kosovë por rritja e këtij trendi në mënyrë të vazhdueshme nuk kontribuon në informim të drejt tek qytetarët dhe natyrisht që zbeh besimin e qytetareve tek mediat. Çrregullimet e informacionit janë shpërndarja dhe publikimi, me ose pa qëllim, i informacioneve të pavërteta, të manipuluar, të ekzagjeruara apo që përmbajnë gjuhë të ashpër, seksiste dhe të urrejtjes. Duke e ditur këtë shpërndarje me shpejtësi të madhe të informacionit, atëherë edhe popullata në Kosovë është fragjile ndaj shpërndarjes së informatave të çrregullta nëpër portalet online dhe rrjetet sociale, nga kjo del që mundësia që qytetarët të lexojnë lajme me çrregullim të informacionit është e madhe, pasi që në shumë portale online dhe rrjete sociale, përdoret gjuhë ofenduese, e ashpër, seksiste, lajme që përmbajnë tituj të ekzagjeruar dhe lajme me përmbajtje të rreme.

Duke parë numrin e madh të lajmeve të shpërndara me karakteristika të tilla dhe me qëllim të identifikimit të tyre, Instituti D4D vazhdon të monitoroj portalet dhe rrjetet sociale, dhe ky është raporti i tretë. Në vitin e kaluar D4D, ka lanësuar *raportin e parë*<sup>2</sup>, ku është bërë

---

<sup>1</sup> Simon Kemp, Datare Portal, Digital Kosovo, 2022: e qasshme në:

<https://datareportal.com/reports/digital-2022-kosovo#:~:text=Internet%20use%20in%20Kosovo%20in,unchanged%20between%20021%20and%202022.>

<sup>2</sup> Fushata Zgjedhore në Llupe: A e cenon integritetin e zgjedhjeve çrregullimet e informacionit: e qasshme në: <https://d4d-ks.org/punimet/fushata-zgjedhore-ne-llupe/>

monitorimi i fushatës zgjedhore dhe balotazhit në Kosovë, ndërsa në fillim të këtij viti është lanësuar *raporti i dytë*<sup>3</sup>, me monitorimin e portaleve online dhe rrjeteve sociale për muajt tetor-nëntor dhe dhjetor dhe rrjedhimisht ky është *raporti i tretë* i lansuar nga Instituti D4D, ku janë monitoruar portalet online dhe rrjetet sociale. Në këtë raport përfshihet periudha e monitorimit nga 1 janari deri me 31 mars. Këtu është përfshirë monitorimi i kategorive: Ndasitë Politike dhe gjuha e ashpër, Ndikimi i Jashtëm, Gjykata Speciale, Dialogu Kosovë – Serbi, Mizogjenia dhe dhuna online ndaj grave dhe Covid-19. Veçori e këtij raporti përveç kategorive të lajmeve që janë analizuar edhe në raportet e kaluara, ky raport përfshin edhe analizimin e artikujve që është raportuar për konfliktin Ukrainë-Rusi, lajme këto të cilat janë futur në kategorinë e Ndikimit të Jashtëm. Këto kategori të lajmeve janë analizuar në dy gjuhë; shqip dhe serbisht. Karakteristikë e këtij raporti, që ka dalur nga monitorimi i portaleve online dhe rrjeteve sociale janë artikujt me përmbajtje të *gjuhës së ashpër*, *gjuhës së urrejtjes* dhe lajme me *titull të ekzagjeruar*. Çka vlen të theksohet se në kategorinë e artikujve të Ndikimit të Jashtëm ka pasur lajme me përmbajtje konspirative. Kategoria e Ndasive Politike dhe gjuhës së urrejtjes dhe kategoria Ndikimi i Jashtëm janë dy kategoritë që e karakterizojnë këtë raport me thuajse numrin më të madh të narrativave. Raporti përmban konkluzione dhe rekomandime të cilat u drejtohen portaleve online, subjekteve politike, gazetarëve si dhe qytetarëve.

---

<sup>3</sup> Portalet dhe Rrjetet Sociale në Llupë: Sa po ndikojnë çrregullimet e informacionit në jetën e qytetarëve, e qasshme në: [https://d4d-ks.org/wp-content/uploads/2022/03/D4D\\_Q1report\\_SHQ\\_Final.pdf](https://d4d-ks.org/wp-content/uploads/2022/03/D4D_Q1report_SHQ_Final.pdf)

## 2 | Metodologjia

Qëllimi i këtij raporti është identifikimi i lajmeve të pavërteta të cilat kanë pasur synim keq-informimin e qytetarëve, nxitjen e urrejtjes për individ ose grupe të ndryshme, si dhe familjarizimin e publikut me prezencën e çrregullimeve të informacionit dhe nevojën për vërtetim të lajmeve. Sikur në raportet paraprake edhe në këtë raport janë analizuar dhe pasqyruar artikujt me çrregullim të informacionit që publikohen dhe shpërndahen nëpër portale online dhe rrjetet sociale në Kosovë në dy gjuhë; shqip dhe serbisht.

Instituti D4D, ka vazhduar me monitorimin e portaleve online dhe rrjeteve sociale. Ky raport ka përfshirë periudhën e monitorimit të artikujve në portale online dhe rrjete sociale për tre muaj, **1 janarit** deri më **31 mars**. Monitorimi është bërë duke përdorur dy platformave *MediaToolkit* dhe *Crowdtangel*. Monitorimi është bërë paralelisht edhe në mostrën në gjuhën shqipe dhe atë serbe. Në mostrën në gjuhën shqipe janë monitoruar 76 portale online, 203 faqe dhe 10 grupe në rrjetin social Facebook dhe 32 llogari në rrjetin social Twitter. Nga monitorimi i këtyre portaleve online dhe rrjeteve sociale janë identifikuar 154 artikuj që kanë përmbajtje të çrregullimit të informacionit. Ndërsa në mostrën në gjuhën serbe janë monitoruar 55 portale online, 16 faqe dhe 1 grup në rrjetin social Facebook dhe 18 llogari në Twitter, me ç'rast kanë rezultuar 23 artikuj me çrregullim të informacionit. Ku gjithsej numri i artikujve me çrregullim të informacionit për të dyja mostrat ka qenë 176.

Tabela 1. Numri i portaleve online dhe rrjeteve sociale të monitoruara në këtë periudhë.

		Facebook		Portale Online	Llogari në Twitter
		Faqe	Grupe		
Mostra	SHQ	203	10	76	32
	SRB	16	1	55	18
<b>Gjithsej</b>		<b>411</b>			

Arsyeja pse janë përdorur dy platformat e lartë cekura është se të dy këto platforma bëjnë mbledhjen e të dhënave numerike. *MediaToolkit* ka bërë matjen e lexueshmërisë potenciale (reache) të artikujve dhe postimeve në portalet online dhe llogaritë në Twitter, *Crowtangel* ka bërë matjen e ndërveprimeve (like, love, care, haha, wow, sad, angry, comment dhe share) në rrjetin social Facebook.

Duhet theksuar fakti që shumë portale online të Kosovës të cilat operojnë në gjuhën serbe marrin lajme direkt nga portalet online nga Serbia, një pjesë e konsiderueshme e portaleve të monitoruara në mostrën në gjuhën serbe janë portale që operojnë në Serbi dhe Bosnje e Hercegovinë. Gjithashtu tek mostra në gjuhën shqipe janë të përfshirë edhe disa portale që operojnë në Shqipëri dhe Maqedoni të Veriut. Në përmbajtje të këtij raporti do të përfshihen shembuj nga mostra në gjuhën shqipe dhe ajo serbe. Portalet online, faqet dhe grupet në Facebook dhe llogaritë në Twitter janë përzgjedhur duke marrë për bazë kriterin e numrit të ndjekësve që ato kanë pasur, bazuar në faktin që ato mund ta kenë ndikimin më të madh tek qytetarët dhe shpejtësia e shpërndarjes së informatës mund të jetë shumë herë më e lartë sesa ato që kanë numër më të vogël të ndjekësve, Po ashtu portalet online janë përzgjedhur në bazë të adresës së një portali, numër kontaktues të portalit, në bazë të asaj që një portal ka një kryeredaktor dhe redaktor. Kemi ndërtuar një bazë

të fjalëve kyçe në platformat me të cilat kemi bërë monitorimin, për të identifikuar më mirë lajmet të cilat ndërlidheshin me zgjedhje.

Kategoritë në të cilat është fokusuar rapori janë: Ndikimi i jashtëm, ndasitë politike dhe gjuha e ashpër, Gjykata speciale, dialogu Kosovë – Serbi, Covid-19, mizogjenia dhe dhuna online ndaj grave. Mirëpo çfarë e veçon këtë raport me ato paraprake është fokusi më i madh në artikujt dhe postimet që raportuan për agresionin Ukrainë - Rusi. Në këto kategori është bërë monitorimi i çrregullimeve të informacionit ku përfshihen shpërndarja dhe publikimi, me ose pa qëllim, i informacioneve të pavërteta, të manipuluar, të ekzagjuruara apo që përmbajnë gjuhë të ashpër, seksiste dhe të urrejtjes. Për secilën nga kategoritë fillimisht janë filtruar artikujt dhe postimet me lexueshmëri potenciale më të madhe si një mënyrë për të matur ndikimin e këtyre artikujve tek lexuesit, ndërsa më pas është bërë analizimi i përmbajtjes së artikujve duke i klasifikuar ato në kategori të lajmeve që përmbajnë çrregullim të informacionit.

Bazuar në këto kategori, Instituti D4D ka bërë edhe klasifikimin e artikujve me përmbajtje të çrregullt të informacionit, ku përqindja më e madhe e artikujve me çrregullim të informacionit në këtë raport në mostrën në gjuhën shqipe vie nga kategoria e ndikimit të jashtëm dhe ndasitë politike. Deri sa në kategorinë e ndasive politike është përdorur, gjuhë e ashpër dhe ofenduese, tituj të ekzagjeruar, në kategorinë e ndikimit të jashtë kanë dominuar lajme të pavërteta, fotografi dhe video të nxjerra jashtë kontekstit dhe lajme konspirative. Ndërsa në mostrën në gjuhën serbe kategoria që ka pasur më së shumti artikuj me çrregullim të informacionit është ajo e ndasitve politike dhe gjuha e ashpër.

Informatat gjatë procesit të monitorimit janë ruajtur për shkak të vërtetësisë së të dhënave si dhe për shkak se disa artikuj apo postime ndonjëherë ndodh që të largohen pas postimit nga portalet ose grupet e caktuara. Me këtë rast kemi krijuar një bazë të të dhënave ku janë ruajtur materialet si në vijim:

- Screenshots; (Pamje të shkëputura nga ekrani)

- Të dhënat numerike si për shembull numri i lexuesve potencial, shpërndarja dhe ndërveprimet e tjera si pëlqimet, komentet dhe shpërndarja;
- Titujt e artikujve me fotografi, datë të postimit dhe emrin e publikuesit të lajmit

### 3 | Të gjeturat kryesore

Gjatë analizimit të artikujve dhe postimeve kemi vërejtur një numër mjaft të madh të lajmeve të cilat kanë pasur informacion të çrregullt, duke përfshirë kështu artikuj dhe postime të cilat kanë promovuar ndasitë politike, ofendimet, gjuhë të ashpër dhe seksiste, gjuhë të urrejtjes, të nxjerra nga konteksti, përmbajtje të pavërtetë, të manipuluar, të fabrikuar dhe tituj të ekzagjërues. Gjithsej, në të dyja mostrat janë gjetur 176 artikuj dhe postime me çrregullime të informacionit. Duke cekur se në këtë raport janë përfshirë edhe artikujt që kanë të bëjnë me konfliktin Ukrainë – Rusi, këto lajme në këtë raport janë kategorizuar tek lajmet që kanë të bëjnë me ndikimin e jashtëm, kategori kjo që ka mbizotëruar me numrin më të madh të artikujve me çrregullimit të informacionit, derisa pas kësaj kategorie janë lajmet e ndasive politike dhe gjuha e ashpër. Në këtë kategori vlen të theksohet se lajmet kanë pasur përmbajtje me gjuhë ofenduese dhe gjuhë të ashpër ndaj krerëve shtetëror, duke përfshirë këtu edhe Kryeministrin e vendit, Albin Kurti, ministren e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, Arbërie Nagavci, ndaj ministres së Drejtësisë, Albulena Haxhiu, deputet dhe politikan të vendit. Ndërsa sa i përket kategorisë së ndikimit nga jashtë, mund të thuhet se lajmet e rreme dhe konspirative kanë mbizotëruar më shumë. Veçori e kësaj kategorie është se kur është raportuar për luftën Ukrainë – Rusi, në portalet online si në gjuhën shqipe ashtu edhe atë serbe, çështja e Kosovës si shtet është përmendur çdo herë duke thënë se pas arritjes së qëllimit rus për pushtimin e Ukrainës, do të pushtohet edhe Kosova nga Serbia, këto lajme janë paraqitur edhe me shembuj që përfshijn raportin. Në mostrën në gjuhën serbe shteti i Kosovës nga liderët shtetëror serb dhe rus është quajtur shtet i rremë dhe shtet i vetëshpallur i pavarur. Me ç'rast raportime të tilla kanë aluduar si lajme manipulative për publikun.

Ndërsa kur flasim për kategoritë tjera dhe bëjmë krahasimin e lajmeve të monitoruar me dy raportet e kaluara, për shembull në lajmet e kategorisë së mizogjenisë në këtë raport kanë qenë më të zbehta, pasi

që vlen të theksohet se në raportet e kaluara, në kohën e zgjedhjeve numri i artikujve është më i madh si dhe komentet ndaj grave në rrjete sociale dhe portale online. Kurse në kategorinë e lajmeve të Gjykatës Speciale krahasuar me raportet e kaluara numri i lajmeve të raportuar në bazë të mostrave të përzgjedhur nuk ka pasur dallime të mëdha. Po ashtu vlen të theksohet se në kategorinë e lajmeve rreth Covid-19, artikuj me çrregullim të informacionit nuk ka, kjo mungesë e këtyre lajmeve vije edhe pas numrit më të vogël të rasteve pozitive me Covid-19 jo vetëm në vendin tonë por në të gjithë botën.

Nga analizimi i lajmeve dhe klasifikimi i tyre me përmbajtje të çrregullimit të informacionit, numri i ndërveprimeve në rrjetet sociale në periudhën janar - mars nëse e krahasojmë me periudhën e zgjedhje lokale, ky raport kishte një numër më të vogël të ndërveprimeve, mirëpo megjithatë ishte më i lartë sesa periudha e raportit të parë (Q-1) tetor-dhjetor 2021. (shih: **grafiken 1**)

Ndërsa, kur flasim për numrin e lexuesve potencial të lajmeve me çrregullime të informacionit gjatë kësaj periudhe ishte më i lartë sesa peirudhat paraprake të marra së bashku. Kjo në fakt tregon seriozitetin e situatës dhe impaktin që lajmet e tilla kanë në formësimin e opinionit publik. Natyrisht që në një rritje të tillë ka ndikuar edhe raportimi i medimeve në lidhje me agresionin rus ndaj Ukrainës (shih: **grafikën 2**).

Grafika 1. Ndërveprimet në rrjetet sociale për periudhën shtator 2021 - mars 2022 në të dyja mostrat. *Burimi: Ilogaritje e D4D-së*



Periudha zgjedhore -  
shtator-tetor 2021

Periudha pas-zgjedhore  
tetor-dhjetor 2021

Raporti I dytë - janar-  
mars 2022

Grafika 2. Lexues potencial të lajmeve të pavërteta për periudhën shtator 2021 - mars 2022 në të dyja mostrat. *Burimi: Ilogaritje e D4D-së*




Tabela 2. Numri i lexuese potencial dhe ndërveprimeve në rrjetet sociale për raportin e dytë (Q-2)

	Nr. i lexuesve potencial	Ndërveprimet në rrjetet sociale
Ndasitë politike	3,761,345	89,145
Ndikimi i jashtëm	6,151,524	73,831
Gjykata speciale	460,990	12,563
Dialogu	99,506	1,666
Mizogjenia dhe gjuha seksiste	77,788	2,618
Covid-19	7,565	57
<b>Gjithsej</b>	<b>10,558,718</b>	<b>179,880</b>

## Ndikimi i jashtëm

Gjatë kësaj periudhe të monitorimit tre mujor të këtij viti, janar – mars, prezenca e lajmeve me ndikim nga jashtë ka qenë më e madhe në krahasim me të gjitha kategoritë e tjera (Shih tabelën 1) për arsyeje të zhvillimeve politike në mbarë botën e që kanë pas një ndikim edhe në mediat në Kosovë. Prandaj vlen të theksohet se në këtë raport tek lajmet e kategorisë me ndikim nga jashtë janë përveç lajmeve politike

rreth çështjes së Kosovës, janë përfshirë edhe lajmet që është raportuar për konfliktin Rusi – Ukrainë. Fotografitë dhe videot me përmbajtje të pavërtetë që mbuluan luftën në Ukrainë ishin të pranishme si në portalet online ashtu edhe në rrjetet sociale. Bazuar në të dhënat e nxjerrura nga CrowdTangle - më saktësisht të dhënat e reagimeve online të lexuesve në postimet në rrjetet sociale.

## Ndasitë politike dhe gjuha e ashpër

Në analizimin e lajmeve për këtë periudhë kemi hasur në çrregullim të informacioni ku është përdorur gjuhë e ashpër dhe gjuhë e urrejtjes ndaj kryeministrit të Kosovës Albin Kurtit, ndaj kabinetit qeverisës së Kosovës, ndaj presidentës së Kosovës, Vjosa Osmanit dhe ndaj njerëzve të politikës. Në këtë kategori gjatë kësaj periudhe të analizimit, të lajmeve është vërejtur një numër i artikujve që kanë pasur përmbajtje të çrregullim të informacionit, duke u përdorur gjuhë e ashpër ndaj personave dhe komuniteteve të caktuar për shembull siç është fjala, ndaj komunitetit LGBTI+. Kjo kategori ishte e dyta sa i përket numrit të lexuesve potencial të lajmeve me çrregullime të informacionit. Megjithatë, ishte e para kategori që nxiti më së shumti reagime nga qytetarët bazuar në të dhënat e reagimeve të tyre në rrjetet sociale (shih tablen 1 - numrin e ndërveprimeve në rrjetet sociale për këtë kategori).

## Mizogjenia dhe dhuna online ndaj grave

Gjuha mizogjenike, është njëri nga fenomenet që në mjedisin medial është shumë prezente përmes artikujve të ndryshëm e shpesh kjo lloj gjuhe përdoret edhe nga politikan, deputet, gazetar e analistë. Gjatë këtij hulumtimi gjuha mizogjenike është përdorur më shumë nga politikanë më saktësisht edhe nga deputetë të Kuvendit të Kosovës.

## Gjykata Speciale

Gjykata Speciale është njëra nga temat që në portalet online që zë një vend të madh rreth publikimit të lajmeve që kanë të bëjnë për personat që janë arrestuar nga po kjo gjykatë, e që disa nga këta persona kanë

qenë krerë të lartë të shtetit të Kosovës, siç është Hashim Thaçi që ka mbajtur pozitën e Presidentit të Kosovës para se të arrestohej, Kadri Veseli po ashtu njëri nga të arrestuarit që ka qenë kryetar i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), deputeti nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, Rexhep Selimi, Jakup Krasniqi ish-kryetar i Kuvendit të Kosovës, Nasim Haradinaj dhe Hysni Gucati anëtarë të Shoqatës së Veteranëve të Luftës, Salih Mustafa drejtor i Departamentit të Inteligjencës në Ministrinë e Mbrojtjes, si dhe Pjetër Shala, ushtarë i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Andaj në këtë raport më së shumti janë vërejtur artikuj me përmbajtje me titull të egzagjuar, lajme që nuk janë bazuar në fakte.


## Ndikimi i jashtëm

Gjatë periudhës së monitorimit janar – mars 2022, prezenca e lajmeve me ndikim nga jashtë ka qenë shumë më e madhe sesa herave të kaluara për arsyeje të zhvillimeve politike në mbarë botën. Këto zhvillime patën ndikim edhe në mediat online në Kosovë - më konkretisht në portalet online dhe rrjetet sociale. Prandaj, vlen të theksohet se në këtë raport tek lajmet e kategorisë me ndikim nga jashtë përveç lajmeve politike rreth çështjes së Kosovës, janë përfshirë edhe lajmet që është raportuar për luftën Rusi – Ukrainë. Për shembull, në mostrën në gjuhën shqipe, numri i lajmeve të prodhuara që kur nisi agresioni i Rusisë ndaj Ukrainës u rrit mjaftë shumë. Nëse krahasojmë pikun e lajmeve në muajin janar me atë të fillimit të luftës në Ukrainë, numri i artikujve të publikuar në portalet online u rrit për 273%. Një rritje të ngjashme u vërejt edhe në mostrën në gjuhën serbe. Në këtë mostër, rritja ishte 200% (shih grafikën 1 dhe 2).

Grafika 3. Numri i lajmeve në portalet online në mostrën në gjuhën shqipe për kategorinë e ndikimit të jashtëm. *Burimi: Mediatoolkit*



Grafika 4. Numri i lajmeve në portalet online në mostrën në gjuhën serbe për kategorinë e ndikimit të jashtëm. *Burimi: Mediatoolkit*




Përhapja e artikujve dhe postimeve me çrregullime të informacionit në shumicën e rasteve u huazuan nga media dhe llogari të rrjeteve sociale të huaja. Sidomos, fotografitë dhe videot me përmbajtje të tillë që mbuluan luftën në Ukrainë ishin të pranishme si në portalet e lajmeve në internet ashtu edhe në mediat sociale dhe për pasojë patën impakt në formësimin e opinionit publik mbi këtë çështje. Gjatë kohës sa është duke u zhvilluar konflikti në mes të Ukrainës dhe Rusisë, lajmet me çrregullime të informacionit nuk kanë munguar në portalet online në Kosovë. Këto narrativa të huazuara nga media të huaja kritikuan Presidentin e Ukrainës, Vladimir Zelensky, ose të tilla narrativa që shpërndanë narrativat e pavërteta ruse në lidhje me qëllimin e intervenimit rus në Ukrainë për të çliruar Ukrainën nga nazistët. Këto lajme kanë gjeneruar artikuj me tituj të ekzagjeruar, lajme të cilat kanë nxitur gjuhë të urrejtjes tek lexuesit dhe lajme të cilat nuk kanë pasur përmbajtje të vërtetë dhe kanë qenë lajme konspirative. Kjo qasje është vërejtur pas analizimit të të dhënave të reagimeve të njerëzve në rrjete sociale (duke marrë për bazë emoji).

Ndërsa sa i përket mostrës në gjuhën serbe lajmet me ndikim të jashtëm më shumë janë karakterizuar me lajme që kanë përmbajtur gjuhë të urrejtjes, lajme jo të vërteta të përdorur nga politikanë serb, deklarata këto që janë publikuar nga portale online në Serbi, me ç'rast vlen të ceket se kanë pasur një lexueshmëri të madhe duke marrë edhe shpërndarje. Gjatë raportimit të këtyre lajmeve shumë narrativa që qarkullonin në portale online bënë krahasime edhe me luftën e Kosovës me Serbinë në vitin 1999 duke tërhequr paralele të pabaza në mes intervenimit të NATO-s në Kosovë dhe agresionit të Rusisë në Ukrainë.

## Shembuj nga mostra në gjuhën shqipe

Një video e shkurtër e postuar portali online 'POLITIKA' nga Shqipëria ka qarkulluar nëpër Facebook. Kjo video është një sekuencë e shkurtër e një interviste të realizuar me Presidentin e Rusisë, Vladimir Putin në të cilën ai pretendon se ishin rusët ata që e çliruan Berlinin nga nazistët, duke mohuar kështu rolin e britanikëve, francezëve dhe amerikanëve. Video pastaj vazhdon me një këngë në rusisht dhe me pamje të trupave të ushtrisë së kuqe. Kjo video është parë më shumë se 1.3 milionë herë, dhe ka gjeneruar 13,486 ndërveprime prej të cilave, 820 shpërndarje, 9,145 pëlqime, 2,765 komente, dhe 756 reagime të tjera.

Putin: "Ushtria e Kuqe çliroi botën nga nazizmi." Jeni dakort?



Pas vizitës së Presidentit të Frances, Emmanuel Makron në Kremlin kishin nisur edhe talljet nëpër rrjetet sociale. Në fakt, janë montuar video dhe fotografi të ndryshme për të reflektuar këtë ngjarje që bazohet në distancën e gjatë të uljes gjatë takimit mes Putin dhe Makron-it. Vlenë të theksohet se kjo video dhe foto të tjera të ngjashme janë bërë nga faqe satirike jashtë Kosovës, dhe pastaj kanë depërtuar edhe nëpër mediat e Kosovës. Kjo video është shikuar më tepër se 131 mijë herë, 2,630 ndërveprime, prej të cilave 453 shpërndarje, 182 komente, 1,195 pëlqime, dhe 800 reagime të tjera.

Nisin talljet me takimin Putin-Macron

Nisin talljet me takimin Putin-Macron 😊



Një video që pati një numër të madh shikimesh ishte ajo që tregonte një formacion avionash me titullin “situatë dramatike në Donbas të Ukrainës, Rusia nis një operacion ushtarak” është nxjerrë jashtë kontekstit. Në të vërtetë, kjo video është realizuar në prill të vitit 2020 dhe nuk është xhiruar në Ukrainë. Videoja është shpërndarë nga disa faqe të tjera në Facebook dhe portale online. Ajo gjeneroi në total 491,310 shikime dhe 5,831 ndërveprime, prej të cilave 4,792 pëlqime, 404 komente, 635 shpërndarje në Facebook dhe tre faqe të tjera në Facebook.



Në fillim të shkurtit, ambasadori i Ukrainës në Shqipëri, Volodymyr Shukrov, në një intervistë të dhënë për Euronews deklaroi se kishte njerëz nga Kosova dhe Shqipëria që kishin shprehur gatishmëri që vullnetarisht të shkonin në luftë për të mbështetur frontin Ukrainas kundër

"Mercenarë SHQIPTARË e KOSOVARË po dërgohen në Ukrainë"/ Deklarata bombë e Rusisë




Albanian and Kosovan Mercenaries are being sent to Ukraine/Bombastic declaration from Russia

Rusisë. Pak ditë pas kësaj deklarate, si kundërpërgjigje ndaj saj, ministri i jashtëm i Federatës Ruse Sergei Lavrov deklaroi rrejshëm se kosovarët dhe shqiptarët po dërgoheshin në Ukrainë. Kjo sepse Ambasadori i Ukrainës foli vetëm për gatishmërinë e kosovarëve dhe shqiptarëve për të mbështetur Ukrainën por nuk foli se ata kishin shkuar tashmë në luftë. Ky artikull ishte publikuar në të paktën shtatë portale lajmesh online fillimisht duke u publikuar në mediat shtetërore ruse, e më pas u ripublikua në Serbi, Shqipëri dhe Kosovë. Artikujt në

portalet në gjuhën shqipe patën 94,754 lexues potencial dhe gjeneruan 1,184 ndërveprime në Facebook prej të cilave 578 pëlqime, 302 komente 123 reagime të ashpra, dhe 181 shpërndarje. Gjithashtu, lajmu u ripublikua në pesë portale të tjera online. Ndërkaq, në portalet në gjuhën serbe këto artikuj që përmbanin narrativin e njëjtë patën 817,700 lexues potencial, dhe 14,500 shpërndarje.

Grafika 3. Skema e depërtimit të narrativave të pavërteta ruse në rajonin e Ballkanit perëndimor. *Burimi: hulumtim i D4D.*



Lajmi me titullin “Luftë në Ballkan?! Çmendet Vuçiç, i kërkon Rusisë të pushtojë Kosovën”, është artikull që raportoi për zhvillimet në Ukrainë dhe Rusi. Në Kosovë këto zhvillime po marrin konotacion ndryshe të raportimit, duke i ekzagjeruar titujt dhe informatat, për shembull duke pohuar se




Serbia do ta pushtojë Kosovën. Ky artikull përmban titull të ekzagjeruar ku mund të krijohet edhe frikë tek lexuesit me ç’rast mund të thuhet se është edhe një titull që tërheqë klikueshmëri të lartë. Ky artikull ka pasur 251.647 lexues potencial dhe 1,069 ndërveprime në rrjete sociale, prej të cilave 915 pëlqime dhe 154 komente.

Një artikull që mbante titull të ekzagjeruar dhe përmbajtje të pavërtetë ishte ai që citonte kancelarin e Gjermanisë Olaf Scholz. *“Flakë për flakë” / Putin i kujton bombardimin e Serbisë, kancelari gjerman bën deklaratën ‘bombë’ për Kosovën*, që ishte publikuar në shkurt të këtij viti, është një lajm me titull të

ekzagjeruar për të hamendësuar lexuesit. Ndërkaq, në përmbajtjen e artikullit është vetëm një deklaratë e kancelarit gjerman që deklarohej për luftën në Jugosllavi dhe rreziqet e përhapjes së gjenocidit atje dhe se lufta e NATO-s e ka parandaluar përhapjen e tij. Në deklaratë kancelari gjerman, nuk përmend në asnjë formë Kosovën. Ky artikull ka pasur 99,755 lexues potencial, 641 ndërveprime në rrjete sociale, prej të cilave 599 pëlqime, 37 komente dhe 5 shpërndarje.

Një fjalim kontravers i mbajtur nga një imam në Shkup ka nxitur reagime të mëdha dhe raportim mjaft të gjerë nga ana e portaleve online dhe rrjeteve sociale për shkak të përmbajtjes së gjuhës së përdorur. Imami deklaroi se konflikti në Ukrainë nuk është i rastësishëm. Ai foli pa fakte se Presidenti aktual i

Ukrainës duke aktruar qante për Jahuditë, derisa në anën tjetër Israeli me gjithë artilerinë po e bombardonte Palestinën dhe po vriste fëmijët e paarmatosur dhe të pafajshëm. “Neve na dhimbjen të pafajshmit, por zullumçarët s’duhet me na u dhimt hiq, tash zullumçarit e kanë



Hoxha nga Shkupi e quan presidentin ukrainas "dreq": Zullumçarët aspak s'duhet me na u dhimbs



gjetë te Rusia” shtoi ai. Kjo është një gjuhë e rëndë me elemente antisemitike të cilën disa portale online dhe postime në Facebook nuk e dënuan nga 207 postime dhe artikuj, vetëm 14 prej tyre e denoncuan gjuhën e përdorur. Ky lajm ka arritur tek më shumë se 138,194 lexues potencial ndërsa ka gjeneruar 9,788 ndërveprime, prej të cilave 3,028 pëlqime, 5,782 komente, dhe 239 shpërndarje, 572 reagime (emoji) të neverikosur.



Një lajm i publikuar nga portalet online në Kosovë me titull: “A do të duhej Rugova të vepronte si Zelensky?” ka ngjallur shumë reagime tek komentuesit e këtij lajmi duke shprehur gjuhë të urrejtjes ndaj deklaratës që kishte bërë ish-veprimtari i politikës kosovare, Adem Demaçi i cili flet për periudhën e luftës në Kosovë dhe negociatat të cilat i ka bërë ish-presidenti i Kosovës, Ibrahim Rugova. Ku për të arritur tek ky konkludim janë analizuar mbi 400 komente që janë shkruar në postimin e këtij lajmi. Ky lajmë pati 255,290 lexues potencial, dhe 4,352 ndërveprime në rrjete sociale, prej të cilave 3,096 pëlqime, 489 komente dhe 767 shpërndarje.

Një nga artikujt që ka qarkulluar më së shumti në këtë periudhë e që ndërlihet me konfliktin në mes të Ukrainës dhe Rosisë është lajmi me titull: “Putin ka vdekur, u vra dy vjet më parë dhe Rusia po udhëhiqet nga sozia e Vladimirit”, ky lajm nuk është i vërtetë dhe është konspirativ. Ky lajm pati 142,903 lexues potencial, dhe 778 ndërveprime në rrjete sociale, prej të cilave 659 pëlqime dhe 119 komente.



Putin ka vdekur, u vra 2 vjet më parë dhe Rusia po udhëhiqet nga sozia e Vladimirit

Artikulli me titullin: *“Ministri i Jashtëm rus bën deklaratën tronditëse: Kosova është shtet kriminal i vetëshpallur”*, është lajm që

përmban çrregullim të informacionit ku është përdorur gjuhë ofenduese dhe e ashpër ndaj një vendi, në këtë rast ndaj Kosovës. Kjo deklaratë e ministrit të jashtëm rus, është postuar në mediat e gjuhës shqipe duke raportuar se është deklaratë e ministrit rus

dhënë për mediat serbe. Ky artikull ka pasur 23,400 lexues potencial dhe ka marr 107 pëlqime, 173 komente dhe 30 shpërndarje.

Ministri i Jashtëm rus bën deklaratën tronditëse: Kosova është shtet kriminal i vetëshpallur

Foto: Reuters Shqipëri - 11 Mars 2022



## Shembuj nga mostra në gjuhën serbe

Në artikullin “A. Paviq: SHBA nuk ka të drejtë morale t’i predikojë askujt”, folësi i ftuar në një emision shprehet se “amerikanët, të cilët sot e fituan territorin e tyre me gjenocid, të cilët janë të vetmit në histori që përdorin armë bërthamore kundër civilëve, nuk kanë të drejtë morale për t’i thënë ndonjë gjë dikujt”. Kjo tregon

se Amerika jo vetëm që nuk ka të drejtë të fajësojë Rusinë, por nuk ka të drejtë të fajësojë askënd në botë”. Nëpërmjet një narrative të shtrembër fokusi kryesor i publikut tentohet të zhvendoset nga veprimet aktuale ruse në Ukrainë në ndërhyrjet e mëparshme të SHBA. Ky artikull kishte një shtrirje prej 179,800+ dhe 549 shpërndarje.

Në artikullin e titulluar “E vërtetuar se ata rrisin murtaja”: Amerika konfirmoi ekzistencën e laboratorëve në Ukrainë, shkatërroi kontejnerë me patogjenë”, thuhet se SHBA-të dhe autoritetet ukrainase po punojnë fort për të fshehur provat.

Mbyllja e nxituar e labororit dhe veprimi i asgjësimit të provave justifikohen me rrezikun e pretenduar se rusët mund të vinin në zotërim të këtyre materialeve kërkimore. Ky është dezinformim, i dëshmuar edhe nga disa organizata të kontrollimit të fakteve në rajon. Ky artikull pati 97,700 lexues potencial dhe 772 shpërndarje në



### PRIZNALI DA SU GAJILI KUGU: Amerika potvrdila postojanje laboratorija u Ukrajini, uništili kontejnere sa patogenima

Večernje Novosti — 9. marta 2022, 22:07



POSLE višegodišnjih upozorenja, sumnji i optužbi stiglo je i priznanje – Amerika je u Ukrajini razvijala biološko oružje. I dok Rusija i Kina najavljuju ofanzivu za utvrđivanje odgovornosti pred međunarodnim telima koja nadziru istraživanje i primenu opasnih patogena, SAD i ukrajinske vlasti svim silama se trude da uklone tragove. Brzopotetno zatvaranje laboratorija i akciju uništavanja dokaza pravdaju tobožnjom opasnošću da bi Rusi mogli da dodu u posed ovih istraživačkih materijala

(Večernje novosti)

Facebook dhe Twitter. Ai gjithashtu u ripublikua nga të paktën 12 portale të tjera.

## Dialogu Kosovë - Serbi

Edhe gjatë kësaj periudhe të monitorimit të lajmeve janë analizuar edhe artikujt dhe postimet rreth çështjes së dialogut Kosovë - Serbi. Mirëpo krahasuar me raportet e kaluara, në këtë kategori të lajmeve numri i lajmeve është më i vogël pasi që fokusi i zhvillimeve politike gjatë këtyre muajve ka qenë tek kategoria e lajmeve të ndikimit të jashtëm. Mirëpo në mesin këtyre lajmeve të analizuara janë vërejtur, artikuj dhe postime që kanë përmbajtur gjuhë të urrejtjes, lajme me titull të egzagjeruar dhe lajme me përmbajtje të rreme. Përdorimi i gjuhës së urrejtjes është më i theksuar në mostrën në gjuhën serbe.

## Shembuj nga mostra në gjuhën shqipe

Artikulli me titullin: “Një “kalë Troje” nga Serbia brenda territorit të Kosovës?/ Vjen porosia për Kurtin e Osmanin para nënshkrimit të marrëveshjes finale”, është njëri nga lajmet në kategorinë e ndikimit nga jashtë që ka pasur një lexueshmëri mjaftë të madhe. Ky artikull ka të bëjë me vizitën e përfaqësuesit të ShBA-së për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, në Kosovë, të cilit ju kanë referuar si “Kali i Trojes”. Mund të themi se ky referimin që iu është bërë përfaqësuesit Escobar është gjuhë e urrejtjes. Ky lajm ka pasur 8,866 lexues

**Një “kalë Troje” nga Serbia brenda territorit të Kosovës?/ Vjen porosia për Kurtin e Osmanin para nënshkrimit të marrëveshjes finale**

nga A.SH ME: 3 SHKURT 2022 NË ORA: 14:12



potencial, dhe 229 ndërveprime në rrjete sociale, prej të cilave 194 pëlqime, 27 komente dhe 8 shpërndarje.

Artikulli me titullin: *“Serbia dorëzohet përballë Albin Kurtit, PDK në sinkron me Aleksandër Vuçiqin”*, i botuar në njëri nga portalet online, hynë në kategorinë e lajmeve me përmbajtje të ekzagjeruar dhe gjuhë ofenduese dhe të urrejtjes, duke e quajtur Partinë Demokratike të Kosovës (PDK), tradhtarë. Përveç kësaj, në këtë artikull thuhet se PDK ka sinkronizuar dekoratat dhe qëndrimet e tyre me Ministrinë e Punëve të Jashtme të Serbisë, Nikola Selaković, konkludim ky që nuk është bazuar në asnjë fakt, andaj kjo del të jetë edhe një lajm jo i vërtetë. Ky artikull ka pasur 35,430 lexues potencial, dhe 740 ndërveprime në rrjete sociale, prej të cilave 595 pëlqime, 85 komente dhe 60 shpërndarje.

Artikulli me titullin: *“Vlora Çitaku kishte arritur marrëveshje me serbët për ndarjen e Kosovës”/ Kërkohej gjykimi për tradhti për Hoxhajn, Çitakun e Bujën*, është në mesin e lajmeve që përmban çrregullim të informacionit pasi që nuk ka fakte se

### Serbia dorëzohet përballë Albin Kurtit, PDK në sinkron me Aleksandër Vuçiqin

NGA: P.R. ME: 1 SHKURT 2022 NË ORA: 18:57



Albin Kurti

### POLITIKA

**“Vlora Çitaku kishte arritur marrëveshje me serbët për ndarjen e Kosovës”/ Kërkohej gjykimi për tradhti për Hoxhajn, Çitakun e Bujën**

NGA: A.Z. ME: 16 SHKURT 2022 NË ORA: 22:17



ekziston një marrëveshje në mes Vlora Çitaku anëtare e Partisë Demokratike të Kosovës dhe Serbisë për ndarjen e Kosovës. Në bazë të kontekstit të narrativit ky lajm ka përmbajtje jo të vërtetë të informacionit. Ky lajm ka pasur 25,290 lexues potencial dhe 304 ndërveprime në rrjete sociale, prej të cilave 137 pëlqime, 80 komente dhe 87 shpërndarje.

## Shembuj nga mostra në gjuhën serbe

Lajmi që mban titullin: *“Serbëve në Kosovë dhe Metohi nuk ju lejohen as varrezat: Veprim i turpshëm i shtetit të rrem në Zadushnice”*, është një lajm që permban deklaratën e Petar Petković, Drejtor i Zyrës për Kosovë dhe Metohi në Serbi që është postuar në portalet online në Serbi që mund të cilësohet si jo i vërtetë për shkak se Kosova është shtet i Pavarur që e ka shpallur pavarësinë e saj më 18 shkurt 2008 dhe i njohur nga shumë vende të botës. Gjithashtu, ky artikull përmban edhe gjuhë të urrejtjes duke e quajtur Kosovën “Kosovo Metohija”. Ky lajm ka pasur 3,381 lexues potencial, 22 ndërveprime prej tyre 13 pëlqime, 1 koment dhe 8 shpërndarje.

Lajmi që mban titullin: *“Kriminel, nuk do të ju falim: Klark justifikon bombat e NATO-s në RFJ, Haradinaj kërcënon me bombardime të*

### SRBIMA SA KOSOVA I METOHUJE NE DAJU NI NA GROBLJE: Sramna akcija policije lažne države na Zadushnice (FOTO)



*reja!*", është njëri nga lajmet që ka qëndruar në ballina të portaleve online serbe, ku Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq e quan budalla deputetin e Kuvendit të Kosovës, Ramush Haradinaj, për deklaratën që kishte thënë se "Po kaloi një oficer i Serbisë në territorin e Kosovës, do të bombardohet Beogradi", të dy këta politikan, Presidenti i Serbisë, Aleksander Vuçiq dhe deputeti i Kuvendit të Kosovës, Ramush Haradinaj, kanë përdorur gjuhë të urrejtjes. Ky artikull ka arritur tek 599,110 lexues potencial dhe 14,022 ndërveprime në rrjete sociale, prej të cilave 373 shpërndarje, 6,863 komente dhe 6, 786 pëlqime dhe është riprodhuar 4 nga portale tjera online.

Titulli me lajmin: *"Petkovic: Për dialog duhen dy palë: Prishtina po perpiqet të dobësoj interesat kombëtare serbe"*. Këtu Petkovic ka dhënë deklarata ku thotë se për dialogun janë të nevojshëm dy palët Prishtina edhe Beogradi, mirëpo sipas tij, Prishina po tenton që të dobësoj interesat nacionale serbe, ai vazhdon duke thënë se prej

fillimit të këtij viti janë regjistruar 23 incidente dhe sulme ndaj popullatës serbe në Kosovë e Metohije, gjegjësisht 150 prej ardhjes se Kurtit në pushtet. Me këtë deklaratë, politikanin serb, ka përdorur gjuhë të urrejtjes ndaj shteti të Kosovës, përveç kësaj me deklaratën e tij vrehet një lajmi rrem pasi që Kosova është një shtet i pavarur.. Ky lajm ka pasur 1,000 lexues potencial por nuk ka pasur ndërveprime.



Në lajmin me titullin: “Ja si ushtria jugosllave shkatërroi terroristët e klanit: Pamje autentike të çlirimit të Malishevës! Gjendet varri masiv i serbëve të vrarë”, është një artikull i publikuar në portalet online të Serbisë, andaj në këtë titull është përdorur gjuhë e ashpër, gjuhë e urrejtjes dhe titull i ekzagjeruar pasi që brenda tekstit vetëm tregon që nga

UNMIK-u është gjetur një varrezë masive. Ky lajm ka pasur 31,818 lexues potencial dhe 521 ndërveprime prej të cilave 372 pelqime 126 komente dhe 23 shpërndarje.



## Mizogjenia dhe dhuna online ndaj grave

Gjuha mizogjeniste, është njëri nga fenomenet që në mjedisin medial është shumë prezente përmes artikujve të ndryshëm e shpesh kjo lloj gjuhe përdoret edhe nga politikan, deputet, gazetarë e analistë. Gjatë këtij hulumtimi gjuha mizogjene është përdorur më shumë nga politikanë më saktësisht nga deputeti i Kuvendit të Kosovës, Ramush Haradinaj, që njëherëshit është edhe kryetar i paritë Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), i cili në një fjalim në foltoren e Kuvendit, ka përdorur këtë lloj gjuhe ndaj Albulena Haxhiut, Ministre e Drejtësisë. Ndërsa një shembull tjetër që është përmendur në këtë raport është edhe gjuha mizogjene ndaj Vlora Çitakut, nënkryetares së Partisë Demokratike të Kosovës (PDK). Këto artikuj kanë rezltuar pas analizimit të 452 lajmeve vetëm në gjuhën shqipe gjatë periudhës janar – mars. Ndërsa sa i përket mostrës në gjuhën serbe artikuj të tillë nuk ka pasur në mostrën e caktuar për analizimin e artikujve.

## Shembuj nga mostra në gjuhën shqipe

Artikulli me titullin: *“Haradinaj-Haxhiut: Sa herë ta hapsh gojën unë ta kthej”*, është një deklaratë e deputetit të AAK-së në Kuvendin e Kosovës, Ramush Haradinaj, që njëherëshit është edhe Kryetar i partisë AAK. Ai ka bërë këtë deklaratë kundrejtë Ministres së Drejtësisë, Albulena Haxhiut, duke përdorur gjuhë të

ashpër dhe denigruese ndaj saj, duke i thënë “se po e hape gojën”. Kjo deklaratë e deputetit Haradinaj është postuar edhe nga media tjera dhe ka pasur 2,931 lexues potencial dhe 29 ndërveprime në rrjete sociale, prej të cilave 12 pëlqime, 16 komente dhe 1 shpërndarje.

Artikulli me titullin: *“Vlora Çitakut, si ka hije ta këshillojë Albin Kurtin e Qeverinë, para se ta rrëfen tradhtinë”*, është njëri prej artikujve që është publikuar në portalet online, dhe ky artikull përmban çrregullim të informacionit pasi që ndaj nënkryetares së PDK-së, Vlora Çitakut është përdorur gjuhë e ashpër duke e quajtur tradhtarë dhe gënjeshtarë rreth një deklaratë të cilën ajo e kishte bërë në një konferencë për media. Ky artikull ka pasur

14:37 / E Premte, 26 Shkurt 2022 / k.v


### Haradinaj-Haxhiut: Sa herë ta hapsh gojën unë ta kthej



### Vlora Çitakut, si ka hije ta këshillojë Albin Kurtin e Qeverinë, para se ta rrëfen tradhtinë



NGA REXHEP TORTE ME 9 MARS 2022 NË ORA 20:53



7,945 lexues potencial dhe 201

ndërveprime në rrjete sociale, prej të cilave 112 pëlqime, 67 komente dhe 22 shpërndarje.

Artikulli me titullin: *“Ik moj idote”, Kismete Berisha reagon ndaj ministres Nagavci*, është njëri prej artikujve që është publikuar në portalet online, ku është përdorur gjuhë ofenduese ndaj ministres së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Arbërie Nagavci. Ajo është quajtur “idiote”, nga gazetarja, Kimete Berisha. Ky artikull ka pasur 17, 160 lexues potencial dhe 287 ndërveprime, prej të cilave 173 pëlqime, 101 komente dhe 13 shpërndarje.

AKTUALE

### “Ik, moj idote”, Kimete Berisha reagon ndaj ministres Nagavci

NGA: G.B ME: 4 SHKURT 2022 NE ORA: 14:49



## Ndasitë politike dhe gjuha e ashpër

Në analizimin e lajmeve për këtë periudhë kemi hasur në çrregullim të informacioni ku është përdorur gjuhë e ashpër dhe gjuhë e urrejtjes ndaj Kryeministrit të Kosovës, Albin Kurtit, ndaj kabinetit qeverisës së Kosovës, ndaj Presidentës së Kosovës dhe ndaj udhëheqësve të partive politike. Në këtë kategori gjatë kësaj periudhe të analizimit, të lajmeve është vërejtur një numër i artikujve që kanë pasur përmbajtje me çrregullim të informacionit, duke u përdorur gjuhë e ashpër ndaj personave dhe komuniteteve të caktuar për shembull siç është fjala, ndaj komunitetit LGBTI+. Në shembujt që janë pasqyruar edhe më poshtë mostra në gjuhën shqipe përmban më shumë shembuj të artikujve që përmbajnë çrregullim të informacionit, ku për këtë kategori janë analizuar lajme nga janari deri në fund të muajit mars.

Ndërsa sa i përket mostrës në gjuhën serbe artikujt që janë postuar në portale online më së shumti gjuhë e ashpër është përdorur ndaj shteti

të Kosovës, duke u quajtur shtet i rrem. kjo gjuhë është përdorur nga presidenti i Serbisë, Aleksadar Vuçiq. Kjo gjuhë e ashpër e presidentit të Serbisë dhe deklaratat e tij tendencioze rreth mbajtjes së zgjedhjeve serbe në Kosovë, duke thënë se policia kosovare do të gjuajnë me armë ndaj atyre personave që do të dalin të votojnë për zgjedhjet në Serbi. Në bazë të analizimit të kësaj kategorie për këtë periudhe tre mujor mund të thuhet se lajmet me gjuhë ofenduese dhe tendencioze në gjuhën serbe e kanë karakterizuar këtë kategori.

## Shembuj në gjuhën shqipe

Në një fjalim të mbajtur në Kuvendin e Kosovës, kreu i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi ka hedhur akuza ndaj Qeverisë Kurti, ku e ka komentuar shtrenjëtimin e energjisë dhe këtë ia ka atribuar kryeministrit Kurti të cilin e ka akuzuar se ai është përgjegjësi për shtrenjëtimin e energjisë dhe se këtë po e bënë duke e përodrur një organ të pavarur si është Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE). Krasniqi deklaroi se “Ai me këtë politikë po ju qet “haraq” qytetarëve”. Kujtojmë se kriza e energjisë ka ardhur si pasoj e luhatjeve të tregjeve evropiane dhe se kjo është një krizë mbarë-Europiane që ka prekur mbarë Europën - përfshi Kosovën dhe se nuk



Krasniqi: Albin Kurti po dëshiron t'i falë 100 milionë euro KEDS-it



lidhet me politikat qeveritare aktuale. Ky fjalim është parë mbi 40 mijë persona, teksa ka gjeneruar 1,576 ndërveprime, prej të cilave 1,424 pëlqime 102 komente dhe 50 shpërndarje në Facebook. I njëjti fjalim, në një format të një videoje më të shkurtuar Krasniqi ka thënë se Kurti po dëshiron me i falë 100 milionë euro KEDS-it dhe se subvensionimi e ka këtë qëllim. Këtë video e kanë parë mbi 43,4 mijë persona teksa ka gjeneruar 530 ndërveprime, prej të cilave 8 shpërndarje, dhe 522 komente.

Reagime të ngjashme pati edhe nga deputetja Ganimete Musliu nga rradhët e PDK-së, e cila vazhdoi me përdorimin e fjalëve të ashpra ndaj kryeministrit Kurti duke e quajtur atë “frikacak” dhe “komedian”. Për më tepër, Musliu në fjalimin e saj thotë se “Kurti i cilëson rreth 40 përqind të qytetarëve analfabet dhe prandaj bënë ekzibicione me shpjegimi ne tarifave.” Kjo video u shikua nga 7,9 mijë njerëz, pati 539 ndërveprime, prej të cilave 20 shpërndarje, 68 komente, 437 pëlqime dhe 14 reagime të tjera.



Në artikullin me titullin *“Berisha: Kurti i ka mashtruar të gjallët e të vdekurit, të gjallëve mirë ua ka bërë”*, gazetarja Berisha ka përdorur gjuhë ofenduese, ku e ka quajtur kryeministrin Albin Kurti “budalla”. Ajo akuzoi Kryeministrin Kurti se për një vit të qeverisjes së tij vetëm sa i ka varfëruar shqiptarët dhe nuk ka arritur të përmbushë premtimet e tij. Ky artikull ka pasur një shpërndarje të madhe në portalet online duke pasur 58,815 lexues potencial, dhe 1,518 ndërveprime në rrjete sociale, prej të cilave 995 pëlqime, 461 komente dhe 62 shpërndarje.

Në kontekstin e përdorimit të gjuhës së ashpër dhe ofenduese ishte edhe akuza e analistit dhe gazetarit Valon Syla i cili e quajti qeverinë Kurti qeveri të “rrencave” dhe “llaskucave”. Ai e ka quajtur kryeministrin “rrenc” që ka genjyer gjatë 20 viteve, për çmimet, negociatat, pensionet, rrogat, punësimin farefisnor, pandeminë, energjetikën dhe shëndetësinë. Ky artikull është publikuar edhe nga një portal tjetër dhe gjithsej ka pasur 61,034 lexues potencial dhe 1,549 ndërveprime, prej tyre 1,191 pëlqime, 341 komente dhe 85 shpërndarje.



Artikulli me titullin: *“Kimete Berisha: Presidentja i qepoi vetës”,* është njëri nga artikujt me çrregullime të informacionit pasi që ndaj Presidentës së Kosovës është përdorur gjuhë ofenduese. Gazetarja, Kimete Berisha përmes një postimi që ka bërë në profilin e saj në Facebook, ka thënë se presidentja Osmani i ka “qepuar” vetës,

lidhur me shpenzimet për karburant që i ka bërë dhe pas reagimeve të bashkëshortit të presidentes Osmani, i cili i quajti mediat që raportuan për këto shpenzime “ndërmarrje të përbashkëta kriminale”. Ky artikull i botuar në një nga portalet në Kosovë ka pasur 1,455 lexues potencial 20 pëlqime, 28 komente dhe 12 shpërndarje.

Artikulli me titullin: *“E kritikuan arrestimit e Molliqajt ‘shpërthen’ Shkëlzen Gashi: Një huligan”*, është njëri nga lajmet që përmban çrregullimit të informacionit pasi që është përdorur gjuhë ofenduese ndaj Dardan Molliqajt, kryetarit të Partisë Socialdemokrate (PSD), ku analisti politik, Shkelzen Gashi e ka quajtur atë “huligan”. Ky lajm ka pasur 25,875 lexues potencial, dhe 491 ndërveprime në rrjete sociale, prej të cilave 323 pëlqime, 137 komente dhe 31 shpërndarje.

### Kimete Berisha: Presidentja i qepoi vetes

nga Bota Press — 9 Shkurt, 2022 në Lajme, Opinione



### E kritikuan arrestimin e Molliqajt, ‘shpërthen’ Shkëlzen Gashi: Një huligan ...

NGA: A.M. ME: 1 SHKURT 2022 NË ORA: 21:49





Me titullin *“Dëshirojmë të pastrojmë Kosovën nga serbët, Vuçiqi: çdo gjë është e mbuluar pas shqetësimit të rremë për ndereshmëri!”* Vuçiq pretendon se prapa aksioneve të policisë në Shterpçë dhe Brezovicë të cilat bëhen për luftimin e korrupsionit dhe kriminalitetit, qëllimi kryesor është spastrimi etnik i Kosovës e Metohisë. Andaj këto deklarime të presidentit serb, mund të cilësohet jo të vërteta dhe gjuhë e ofenduese ndaj shtetit të Kosovës duke u quajtur Kosova e Metohia. Ky artikull permban gjuhë të urrejtjes dhe nxitë përçarje me motive etnike dhe ka arritur tek 2,113 lexues potencial.

Lajmi me titullin: *“Serbët në Kosovë i besojnë vetëm Vuçiqit: Mijëra njerëz në Graçanicë protestojnë për terrorin e Kurtit”* i referohet deklaratës së kryeministrit të Serbisë Aleksander Vuçiq i cili thotë se “Porosia ime e fundit është që çkado që të ndodh, Serbia do të jetë me popullin e saj”. Ky lajm përman çrregullim të informacionit duke krijuar tek qytetarët konfuzitet dhe duke nxitur urrejtje, duke i quajtur qytetarët e Kosovës, shtetas të Serbisë. Ky lajm ka pas 18,633 lexues potencial dhe 1,443 ndërveprime prej tyre 1,129 pëlqime, 277 komente dhe 37 shpërndarje.



Artikulli me titull: *“Do të kishte qindra të vdekur nëse serbët do të dilnin për të votuar, policia shqiptare do të gjuajne në ta”*. Udhëheqësit politik të Serbisë e kanë konsideruar si dhunë brutale ndaj serbëve të Kosovës mosmbajtjen e zgjedhjeve serbe në Kosovë duke e ekzagjeruar situatën, përveç

kësaj është një deklaratë e eksagjeruar e presidentit serb. Ky lajm ka arritur tek 43, 172 lexues potencial, ka pas 71 shpërndrje, 277 komente dhe 1, 260 pëlqime dhe është riprodhuar nga 2 portale të tjera online.



## Gjykata Speciale

Gjykata Speciale është njëra nga temat që në portalet online zë një vend të madh rreth publikimit të lajmeve që kanë të bëjnë për personat që janë arrestuar nga kjo gjykatë, e që disa nga këta persona kanë qenë krerë të lartë të shtetit të Kosovës, siç është Hashim Thaçi që ka mbajtur pozitën e Presidentit të Kosovës para se të arrestohej ose Kadri Veseli që po ashtu është njëri nga të arrestuarit që ka qenë kryetar i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), deputeti nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, Rexhep Selimi, Jakup Krasniqi ish-kryetar i Kuvendit të Kosovës, Nasim Haradinaj dhe Hysni Gucati anëtarë të Shoqatës së Veteranëve të Luftës, Salih Mustafa drejtor i Departamentit të Inteligjencës në Ministrinë e Mbrojtjes, si dhe Pjetër Shala, ushtarë i Ushtrië Çlirimtare të Kosovës (UÇK).

Andaj, edhe gjatë gjatë analizimit të periudhës janar - mars, të lajmeve që kanë të bëjnë me Gjykatën Speciale janë karakterizuar me lajme me titull të egzagjeruar, lajme që nuk janë bazuar në fakte dhe lajme të cilat janë ngjallur reagim tek publiku. Këto lajme me këto përmbajtje të çrregullimit të informacionit janë evidentuar tek mostra në gjuhën shqipe, ku më posht janë listuar edhe disa nga lajmet që janë nxjerr

nga kjo kategori. Ndërsa në mostrën në gjuhën serbe gjatë kësaj periudhe janë karakterizuar lajme që kanë pasur më shumë gjuhë të urrejtjes. Në portalet online serbe, kjo gjuhë është përdorur ndaj krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), duke i quajtur “bisha”.

## Shembuj në gjuhën shqipe

Artikulli me titullin: *“40 Burgje dhe 40 vrasje të bujshme politike / Nuk shpëton Thaçi nga specialja me propagandë politike të mbrojtjes”*, është botuar në një prej portaleve online në Kosovë. Në përmbajtje të këtij artikulli u pretendua se ish-Presidenti i Kosovës Hashim Thaçi, që është duke qëndruar në paraburgim në Hagë, është duke bërë propagandë dhe se sipas këtij titulli pretendohet se ish-Presidenti Thaçi nuk do të lirohet, duke ju referuar fjalës “nuk shpëton”. Ky konkludim shtrembërohet në emër të faktit se procesi gjyqësor ndaj Thaçit nuk ka mbaruar ende dhe nuk ka ndonjë vendim final. Ky lajm ka pasur 51.224 lexues potencial, dhe 1,018 ndërveprime në rrjete sociale, prej të cilave 636 pëlqime, 289 komente dhe 93 shpërndarje.

Artikulli me titullin: *SKANDAL: Po të mos fsheheshin provat shfaqësuese, Thaçi e të tjerët nuk do të arrestoheshin*

### 40 Burgje dhe 40 vrasje të bujshme politike / Nuk shpëton Thaçi nga specialja me propagandë politike të mbrojtjes

NGA: IDRIZ MORINA ME: 6 SHKURT 2022 NË ORA: 19:47



sipas këtij titulli pretendohet se ish-Presidenti Thaçi nuk do të lirohet, duke ju referuar fjalës “nuk shpëton”. Ky konkludim shtrembërohet në emër të faktit se procesi

Lajmi

### SKANDAL: “Po të mos fsheheshin provat shfaqësuese, Thaçi e të tjerët nuk do të arrestoheshin”

February 4, 2022

1 minute read



*shfajësuese, Thaçi e të tjerët nuk do të arrestoheshin*”, është njëri nga lajmet ku thuhet se Gjykata Speciale është duke i mbajtur të fshehura disa prova shfajësuese ndaj Thaçit dhe krerëve të tjerë të UÇK-se. Një aludim të tillë e ka bërë avokati i Thaçit Gregory Keohe, derisa nuk jepen informata të mëtutjeshme rreth këtyre provave. Ky artikull ka pasur 3,028 lexues potencial dhe 112 ndërveprime në rrjete sociale, prej të cilave 103 pëlqime, 1 koment dhe 8 shpërndarje.

## Shembuj në gjuhën serbe

Artikulli me titullin: “Tani keni mish për pasul?! Bisha Haradinaj! Kriminelet e UÇK-së i prenë koken fëmijës në djep dhe ia hodhen babait të saj për ta shtruar për drekë” i publikuar në portalin online Kurir të Beogradit i referohet deklaratës së Marko Gjuriqit të bërë para pesë viteve ku pretendon për krimet e kryera nga Haradinaj dhe ushtarët e UÇK-së në Kosovë. Ai tregon kinse për dhunimin e një të reje shqiptare dhe vrasjen e një foshnje dyjavëshe ku thotë se i është prerë koka. Për këtë lajm nuk është ofruar asnjë provë - derisa për të gjitha akuzat e tilla Haradinaj është gjykuar tashmë dhe ka dalë i pafajshëm nga gjykata e Hagës, atëherë ky lajm mund të cilësohet si lajm jo i vërtet ku është përdorur edhe gjuhë ofenduese ndaj Haradinajt. Ky artikull ka pasur një shtrirje të madhe në mediat serbe dhe ka pasur 105,520 lexues potencial dhe 2,039 ndërveprime prej të cilave 940 pëlqime, 923 komente dhe 187 shpërndarje.



Titulli: “Shqiptari nuk deshiroi të bashkohet me UÇK-në, ndaj terroristet i vranë djalin, tre vëllezerit dhe tre nipat! Ibraj: Unë kam lindur këtu, nuk kam mundur të shkoj kundër Serbisë”. Ky artikull bazohet në deklaratën e Muharrem Ibrajt që tregon se ka ikur nga Kosova sepse ka qenë i përndjekur siç thotë ai nga terroristët e UÇK-së pasi nuk ka pranuar t’i bashkohet asaj, dhe për këtë arsye i janë vrarë gjashtë pjestarë të familjes. Në fakt, Ibraj ishte vet i akuzuar për vrasje të një shqiptari sa ishte shef i policisë në rajonin e Gjakovës, si dhe kishe mohuar krimet e policisë ndaj civilëve shqiptarë. Duke u bazuar në deklarata të tilla ende të pavërtetuara mund të cilësohet si lajm që përmban çrregullim të informacionit. Ky lajm ka pasur 10,523 lexues potencial dhe 28 ndërveprime në rrjete sociale, prej tyre 26 pelqime, 1 koment dhe 1 shperndarje.

Artikulli me titull: “Akuzat e neveritshme të Kryeministrit të shtetit të rremë në llogari të Serbisë: Kurti shpik

**KURIR**

NARLOVINA TV UÇKVO IZBORI 2022 VESTI STARI SPORT HRONIKA REGION PLANETA ZABAVA

POLITIKA DRUŠTVO **Opinje Sokol** LËNI STAV BIZNIS SRBIJA BEOGRAD QSI INFORMATOR EDUKACIJA

U KICIBI NA PRELAZU VEDA ČUKA, Bugari-kriv 50.000 evra u varli i gendeburim FOTO **YAK** TESHIN SECTRIC OTKROJ ŠTA JE Č

TAJ VIRUS NAAM JE SAD GORI OD KORONE Di Branislav Todorović za Kurir: 3

VUČIĆ O PRITISCI NA SRBIJU: Lebeli nam nad glavom NUSLEKANI UDAR NA SRBIJU, **FR**

RUS SNIŽIO KAKO DU! NAPUŠTA TELO? Evo ki dno prvi ostaje bez živote

**ALBANAC NIJE HTEO U OVK, PA MU TERRORISTI UBILI SINA, TRI BRATA I DVA BRATANCA! Ibraj: Ovde sam rođen, nisam mogao protiv Srbije!**

një shqiptari sa ishte shef i policisë në

**KURIR**

NARLOVINA TV UÇKVO IZBORI 2022 VESTI STARI SPORT HRONIKA REGION PLANETA ZABAVA

POLITIKA DRUŠTVO **Opinje Sokol** LËNI STAV BIZNIS SRBIJA BEOGRAD QSI INFORMATOR EDUKACIJA

NEZ PRLAZI ME, BREDI Preklad programa koji je vodila Mira Vuković, gosti: Hana da uradi OVO, ona pretrudila od STRANAK

BARICA U AUTOBUSU KNEŽE DA SE MAZI PO KOSU! PLAŽE KAZE POSEĆAM JE NA

ALBANCI ODLAZE S KOSMETA: Prevalo skoro 200.000 zarhova za više za ČEKI!

MALA SRBIJA IMALA ŠT DA POKAZE NATO: Izna vobilo koje nametanje VRHOVNE

**MONSTRUOZNO**

**GNUSNE OPTUŽBE PREMIJERA LAŽNE DRŽAVE NA RAČUN SRBIJE: Kurti izmišlja silovanje 20.000 albanskih žena tokom 1999.**

përdhunimin e 20,000 grave shqiptare në vitin 1999” ka qenë një narrativ i pavërtetë që ka qarkulluar nëpër portalet online në gjuhën serbe. Në artikull i referohen deklaratës së Kryeministrit të Kosovës Albin Kurti i cili tha se ishte i shqetësuar se konflikti në Ukrainë mund të përhapet në Ballkanin Perëndimor (...) duke ju referuar të gjitha viktimave, përfshi këtu edhe 20,000 gra që u përdhunun. Ky lajm pati 12,948 lexues potencial, 38 shpërndarje, 13 komente dhe është riprodhuar nga 1 portal online tjetër.

## 4 | Konkluzionet

Gjatë periudhës pas zgjedhore të tre mujorit të fundit të 2021 (tetor - dhjetor) gjatë analizimit të artikujve çrregullim të informacionet është vërejtur më shumë tek lajmet që kanë të bëjnë me Gjykatën speciale, dialogun Kosovë-Serbi dhe pandeminë Covid-19. Tek këta artikuj kanë qenë prezentë lajmet që kanë pas përmbajtje të gjuhës së urrejtjes, tituj të ekzagjeruar, lajme të pavërteta dhe gjuhë të ashpër. Derisa gjatë analizimit të këtyre lajmeve, karakteristikë e tyre ka qenë se të gjithë këta artikuj kanë pasur një numër të madh të lexueshmëri dhe ndërveprime ku një artikull me përmbajtje të gjuhës së urrejtjes ka arritur të gjenerojë deri në 47,939 pëlqime dhe duke u shpërndarë në rreth 112 faqe tjera në rrjete sociale. Fjalime të kombinuara mes gjuhës së urrejtjes dhe shpifjeve janë shpërndarë deri në 207 portale. Pra, këto shifra flasin për përhapjen e shpjetë të lajmeve me përmbajtje të tilla.

Ndërsa në raportin aktual të periudhës janar-mars, në kategoritë e ndikimit të jashtëm, shpërndarja dhe riprodhimi i lajmeve që publikohen nëpër portale të tjera është bërë shumë shpejtë nëpër rrjetet sociale dhe portalet online në Kosovë. Për shembull, në disa raste, një artikull i prodhuar në Rusi është shpërndarë brenda 24 ore në disa shtete, duke arritë në kohë rekorde të manipuloj shumë lexues si brenda vendit, ashtu edhe jashtë. Në kuptimin e ndikimit të jashtëm - që është edhe pjesa më e madhe e narrativave, është vërejtur prezenca e shtuar e fotove dhe videove të montuara të cilat po ashtu kanë ndikuar në formësimin e opinionit në mënyrë të gabuar kur bie fjala për luftën në Ukrainë dhe agresionin rus atje.

Për më tepër, një komponent me rëndësi në kategorinë e ndikimit të jashtëm është aftësia e dezinformatave për të nxitur urrejtje dhe ndasi politike në Kosovë. Në të dyja mostrat, me thekst të veçantë në mostrën në gjuhën serbe është tentuar të bëhet një ndërlidhje e padrejtë e agresionit rus në Ukrainë dhe interventimit të NATO-s në Kosovë.

Në kuptimin e ndasive politike në Kosovë, tema kryesore vazhdon të jetë përdorimi i gjuhës së ashpër, urrjetjes dhe ofendimeve të ndërsjella mes partive politike. Fakte të nxjerrura jashtë kontekstit kanë bërë që këto akuza ndaj njëri-tjetrit të nxisin përçarje edhe tek populli bazuar në të dhënat e analizuara në këtë raport, më saktësisht në bazë të ndërveprimeve të njerëzve në rrjetet sociale.

Këto shifra kaq të larta promovojnë gjuhën e ashpër me ç'rast janë prezente tek një numër i madh te lexuesve që në mesin e tyre mund të ketë lexues edhe të moshave nën 18 vjeçare dhe kjo bënë që të ndikojë negativisht te ata. Andaj është e rëndësishme që mediat t'i informojnë në mënyrë të drejtë dhe të kontribuojnë në integritet të zgjedhjeve por edhe situatës politike në vend përgjithësisht. Në anën tjetër, edhe partitë politike dhe përfaqësuesit e tyre duhet të zgjedhin gjuhën e komunikimit dhe të shmangin përdorimin e termave ofendues.

## 5 | Rekomandimet

### Rekomandimet për portalet

Të verifikohen të gjitha faktet para publikimit të lajmit - sidomos ato që ripublikohen dhe ato që kanë të bëjnë me lajmet që vijnë nga agjencitë e huaja të lajmeve;

Të mos promovohen ndasitë politike dhe gjuha e urrejtjes;

Të raportohet me kujdes dhe përgjegjshmëri për mizogjeninë;

Të implementohet praktika e raportimit të ndjeshëm gjinor;

Gjuha seksiste dhe gjuha e urrejtjes të cilësohen si të tilla në raportimet për to

Të filtrohen komentet në rrjetet sociale të mediave, duke i larguar ato që përmbajnë gjuhë të urrejtjes dhe gjuhë seksiste

Të përmbahen nga përdorimin i titujve të ekzagjeruar që kanë për qëllim gjenerimin e klikimeve

Të gjithë artikujt e sponsorizuar në media të shkruara të kenë një shënim se janë të sponsorizuar nga subjekti politik apo kandidati i subjektit amë

Portalet online si dhe llojet e tjera të mediave (TV, gazeta, radio), të përdorin mënyra të filtrimit për komentet në lajmet që ata shpërndajnë në rrjetet e tyre sociale e që janë me përmbajtje të gjuhës së urrejtjes, gjuhë seksiste dhe ofenduese;

Vendosja e emrit të autorit/gazetarit që ka bërë lajmin, nëse nuk është e mundur vendosen vetëm inicialet e autorit/gazetarit, kjo për arsye të identifikimit të portalit që e kopjon lajmin nga burimet e pa cituara.

## **Rekomandimet për Subjektet Politike**

Të mos promovohen ndasitë politike, që ndikojnë në nxitjen e urrejtjes tek qytetarët

Të mos përdoret gjuha seksiste kundrejt grave

Partitë politike dhe liderët politikë duhet të përmbahen nga gjuha e ashpër, e urrejtjes dhe mizogjeniste

Partitë politike dhe liderët politikë nuk duhet të përfshihen në kampanja dezinformuese

Partitë politike duhet t'i bëjnë publike shpenzimet për fushatë elektorale në rrjete sociale

## Rekomandimet për qytetarët

Të kontrollohet dhe verifikohet, burimi i informacionit, autori, data e publikimit dhe linku i portalit

Të verifikohet vërtetësia e lajmit para se të shpërndahet në rrjete sociale

Të lexohen artikujt në tërësi dhe të mos shpërndahen informata bazuar vetëm në titujt e artikujve

Të përmbahen nga gjuha e urrejtjes dhe gjuha seksiste në komentime në rrjete sociale

## 6 | Shtojcat

## Definicionet e terminologjisë mbi informacionet me përmbajtje të çrregullta

Termi	Definicioni
<b>Çrregullimet e informacionit</b>	Çrregullimet e informacionit janë shpërndarja dhe publikimi, me ose pa qëllim, i informacioneve të pavërteta, të manipuluar, të ekzagjëruara apo që përmbajnë gjuhë të ashpër, seksiste dhe të urrejtjes.
<b>Lexueshmëri potenciale</b>	Lexueshmëria potenciale do të thotë se sa njerëz potencialisht e kanë lexuar artikullin nga artikujt në portalet online. Të dhënat për secilin artikull janë gjeneruar nga platformat me të cilat kemi bërë monitorimin.
<b>Ndërveprimet</b>	Ndërveprimet përfshinë të gjitha veprimet e lexuesve në një postim në Facebook apo në Twitter, ku pëfshihen pëlqimet, komentet, shpërndarja e artikullit apo reagime të tjera si i lumtur, i mërzitur, i nervozuar dhe i habitur.
<b>Dezinformatat</b>	Informacion i paverifikueshëm i rremë ose mashtrues, i krijuar, paraqitur dhe shpërndarë për përfitime ekonomike ose për të mashtruar ndërkombëtarisht

	publikun, i cili mund të shkaktojë dëm publik, kërcënimet ndaj proceseve demokratike politike dhe të politikëbërjes, si dhe të së mirës publike.
<b>Gjuhë e urrejtjes</b>	Fjalimi ose shkrimi abuziv ose kërcënues që shpreh paragjykim ndaj një grupi të caktuar
<b>Mizogjia</b>	Urrejtja, neveria ose paragjykimi ndaj grave
<b>Dhuna online</b>	Përdorimi i pajisjeve ose shërbimeve dixhitale në internet për t'u përfshirë në aktivitete që rezultojnë në vetëlëndim fizik, psikologjik, emocional ose i shkaktojnë dëm një personi tjetër.
<b>Tituj të ekzagjëruar</b>	Titull i krijuar për t'i bërë lexuesit të dëshirojnë të klikojnë në një hiperlink, veçanërisht kur lidhja çon në përmbajtje me vlerë ose interes të dyshimtë.

## Lista e shkurtesave

UÇK	Ushtria Çlirimtare e Kosovës
FSK	Forcat e Sigurisë së Kosovës
ROSU	Njësia Speciale Operative e Policisë së Kosovës
ShBA	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
AAK	Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës
AKR	Aleanca Kosova e Re
LDK	Lidhja Demokratike e Kosovës
PDK	Partia Demokratike e Kosovës
LVV	Lëvizja Vetëvendosje
D4D	Demokraci për Zhvillim

**Katalogimi në botim – (CIP)**

**Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani**

—

07:004

Raportimi i lajmeve nga portalet online- rrjetet sociale dhe ndikueshmëria tek publiku / Demokraci për Zhvillim. - Prishtinë : Demokraci për zhvillim (D4D), 2022. - 30 f. : ilustr. ; 24 cm.

Masmedia – Dixhitalizimi

**ISBN 978-9951-823-33-3**

Aleph [000102768]

Instituti Demokracia për Zhvillim (D4D) është themeluar në prill të vitit 2010 nga një grup i analistëve që po brengoseshin gjithnjë e më shumë që procesi i shtetndërtimit e kishte lënë anash demokracinë.

Vizioni i D4D-së është të promovojë një qytetari aktive dhe të arsimuar, e cila merr pjesë plotësisht në hapësirën publike dhe e përdor arenën publike për përfaqësim dhe vendim-marrje për të diskutuar dhe ndërtuar konsensus për shpërndarjen e resurseve që janë efikase, të shpejta, afatgjate dhe që sjellin zhvillim të barabartë.

D4D ndikon në politikat specifike, promovon një qasje ndër-sektoriale për zgjidhjen e problemeve dhe trajton rutinën institucionale të vendimmarrjes duke rekomanduar përmirësime në rritje dhe operon me efektivitet maksimal në mënyrë që të promovojë plotësisht stabilizimin e Kosovës dhe zhvillimin demokratik.

Për më shumë informata rreth aktiviteteve të D4D-së, ju lutemi vizitoni faqen tonë elektronike: [www.d4d-ks.org](http://www.d4d-ks.org)

